



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:212138

Datë: 29.11.2019

Numri i dokumentit: 00684692

**P.nr.1013/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi dhe zyrtaren ligjore Lavdije Brahimi-Aliu, në çështjen penale kundër të akuzuarve: V.K dhe S.L për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nenpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe të akuzuarës V.K për shkak të veprës penale ne tentativë Shantazhi nga neni 329 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr.1557-6/19 e datës 25.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Albana Parduzi, të dëmtuarit M.I si dhe të akuzuarve V.K me mbrojtës me autorizim Av.D .H dhe S.L me mbrojtës me autorizim Av.A.H , me datë 7 Tetor 2019 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 06.11. 2019 përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- I. E pandehura:** V.K, e lindur me datë ....., nga i ati S... dhe e ëma B... e vajzërisë H....., me vendbanim në magjistralen Prishtinë-Shkup, afër ....., ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, vërtetimi i identitetit është bërë në bazë të nr. personal .....e cila ka qenë në masën e paraburgimit prej datës 28.08.2019 në ora 16:00, deri me datë 11.10.2019 në ora 16:00.

**II. I pandehuri: S.L** i lindur me datë ....., nga i ati B...e ëma R.... e gjinisë B...., me vendbanim në rrugën e “.....” në Tiranë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, vërtetimi i identitetit është bërë në bazë të nr. Personal..... i cili ka qenë në masën e paraburgimit prej datës 28.08.2019 në ora 16:00, deri me datë 11.10.2019 në ora 16:00.

**I. E pandehura V.K,**

### **ËSHTË FAJTOR**

**I.** Me dt.31.07.2019, e pandehura me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete e kanos të dëmtuarin M.I përmes aplikacionit Viber se do ti zbulojë diç në lidhje me të , me fjalët “ a dashtë me familje qetash ki mi la krejt mos ta nin, nga Shqipëria ne Maqedoni edhe videot tash ti nxjerri mos e ki marak hajt te tregoj unë skam punë me t vetëm me grunë tënde”, me qëllim që ta dëmtoj nderin e tij e pastaj me fjalët “... i sjellë lekt makinën e ke në Shqipëri kur të doj zemra veç ki me ardh me marr”, në këtë mënyrë tenton ta detyroj të dëmtuarin të kryej veprim në dëm të pasurisë së tij në shumë prej 16.000 €.

me të cilën ka kryer veprën penale në tentativë shantazhi nga neni 329 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë nenit 329 dhe neneve 4, 7, 8, 17, 21,38, 43,69,70,71,72 të KPRK-së, dhe nenit 365, 370, 453 dhe 463 të KPPK-së, të pandehurën V.K, e

### **G J Y K O N**

#### **II.**

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ Muaj, i cili dënim konform nenit 44 par 1.t’ KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuares i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 1000 /njëmijë/ Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit

- Denim me gjobe në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilin dënimin e akuzuara është i pobliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit.

- Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në mënyrat tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-se, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj një ditë burgimi.

Konform nenit 83 par.1 të KPRK-se, të pandehurës në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në Paraburgim prej datës 28.08.2019 deri me dt.11.10.2019.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që të pandehurës do të llogaritet 20€ për një ditë burgimi.

Obligohet e akuzuara që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/ euro/, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

II. Të akuzuarit V.K dhe S.L, Gjykata, në pajtim të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

## I.

### **LIROHEN NGA AKUZA**

Se me dt. 30-31.07.2019, rreth orës 00:00, në Ferizaj, saktësisht në motelin XXL, e pandehura V.K ia merr pasurinë të dëmtuarit M.I me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që deri sa ishte me të dëmtuarin në motelin e lartcekur, e shfrytëzon situatën kur ai ishte në gjumë dhe ia merr veturën e tipit Mercedes GLE, ngjyrë të bardhë, me targa .... në vlerë prej 94.000 €, pasaportën, letërnjoftimin, disa kartela të bankës dhe 400 € para kesh dhe para të Maqedonisë në konvertim në 100 €, pasaportën e orës, ku pastaj takohet

me të pandehurin S.L i cili thelbësisht kontribuon në kryerjen e kësaj vepre penale duke e kaluar veturën jashtë kufirit për në Shqipëri.

Meqë nuk është provuar se kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari M.I me vendbanim në Lagjen..... Republika e Maqedonisë Veriore, nuk ka paraqitur kërkesës pasurore juridike .

Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me aktakuzën e evidentuar PP/II. nr. 1557-6/19 e datës 25.09.2019, ka ngarkuar të akuzuarit V.K nga Ferizaj dhe S.L nga Tirana Republika Shqipërisë, për shkak të veprës penale se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 si dhe të akuzuarës V.K, për shkak të veprës penale në tentativë shantazhi nga neni 329 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar gjyqësor me datë 27.09.2019, kurse të akuzuari u deklaruan të pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës kurse pas kundërshtimit të provave, Gjykata me aktvendim të dt.07.10.2019, refuzoi pretendimet e të pandehurve të paraqitura përmes mbrojtësve të tyre duke vazhduar me shqyrtimin gjyqësor me datë 07.10.2019,në të cilat shqyrtim gjyqësor të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm për akuzat, Kurse prokurorja e shtetit Albana Parduzi ika propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpall fajtor dhe t iu shqiptohet dënimi për veprat penale.

### **Mbrojtja e të akuzuarve**

E akuzuara V.K , në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale në fjalë, kurse me rastin e paraqitjes së mbrojtjes ka mohuar faktin se bashku me të pandehurin S....ti kenë vjedhur veturën të dëmtuarin pasi që ata ishin në lidhje dhe e njëjta atë veturë e ka marrë edhe herave tjera në shfrytëzim dhe kjo nuk ishte hera e parë, dhe asnjëherë nuk ka kërkuar leje nga M....(i dëmtuari) që ta marrë në shfrytëzim veturën, duk potencuar se i njëjti i kishte thënë se (çka do që është e imja është edhe e jotja).

Në pjesën e mbrojtjes së saj e pandehura e ndërlidhë faktin me motivin dhe qëllimi në natën që e kishte marrë veturën ishte për një shëtitje në një festë të organizuar në qytetin e Sarandës për disa dit dhe t'ia kthej veturën dhe jo për ndonjë qëllim për ta përvetësuar për ndonjë përfitim pasuror, e as ta shes dhe të njëjtën ka dashur ta kthejë por i dëmtuari nuk e ka pranuar.

E pandehura gjatë mbrojtjes së saj ka potencuar, se atë natë pasi që ka dal nga Hoteli.... me veturën e të dëmtuarit e ka thirr në telefon te pandehurin S.... dhe e ka ftuar të shkojnë në Shqipëri së bashku për një pushim një javor dhe me të pandehurin S..... ishin tek pompa e derivateve .... në Prishtinë , ku kanë qëndruar një orë e gjysmë dhe ishin nisur për në Shqipëri.

Më tutje gjatë mbrojtjes së të pandehurës shton faktin se gjatë gjithë kohës veturën e kishte vozitur e njëjta e jo S..... dhe nuk kishte qenë në dijeni S.... se e njëjta kishte qëndruar së bashku me M.I në Hotelin.....në magjistralen Ferizaj Prishtinë dhe nuk e ka ditur e kujt është vetura duke shtuar se nuk ja kishte treguar të vërtetën duke e gënjyer të njëjtin, gjithashtu i njëjti nuk e kishte vërejtur kur ka biseduar në telefon me M..... me arsyetimin se nuk ka qenë i pranishëm. Më tutje e pandehura ka potencuar se të pandehurin e dytë –S.... ishte në lidhje dashurie prej 5-6 muaj dhe i njëjti nuk ka qenë në dijeni për lidhjen e saj me M.I. Gjithashtu shton se nuk kishte për qëllim që ta vjedhë atë veturë por vetëm e ka marrë në shfrytëzim për një shëtitje dhe qëllimi i saj ka qenë t'ia kthej të dëmtuarit – M...., pa si që nuk kishte qenë hera e parë që e kishte marrë në shfrytëzim veturën e të dëmtuarit, me që e njëjta nuk ka pritur që i dëmtuari – M.....nga xhelozia do ta denoncoj në polici të njëjtën për veprë penale Vjedhje e rëndë. E njëjta ka potencuar se pasi kishte kontaktuar me telefon me të dëmtuarin dhe i kishte treguar për vendodhjen e veturës, i njëjti kishte kërkuar nga e pandehura ta mbaj veturën, ndërsa dokumentacionin t'ia kthej të dëmtuarit.

Ndërsa sa i përket veprës penale në tentativë shantazhi e njëjta e mohon kryerjen e kësaj vepre penale, duke shtuar se nuk i ka kërkuar 16.000 /gjashtëmbëdhjetë mi euro/€, si dhe mesazhet nuk i ka shkruar e pandehura, duke shtuar se nuk e posedon numrin e telefonit nga i cili

janë shkruar mesazhet, në instagram dhe të kërkoj të holla në emër të saj, sepse gjat asaj kohe nuk kishte përdorur Viber por vetëm Whatsap

I akuzuari **S.L** me mbrojtës me autorizim Av.A.H, në fillim të shqyrtimit gjyqësor si dhe gjatë mbrojtjes së tij ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se të pandehurën V.... e njeh që 3-4 muaj dhe nuk ka qenë në dijeni se e njëjta ka qenë në ndonjë lidhje dashurie me ndonjë person tjetër dhe asnjëherë nuk ka dëgjuar për personin me emrin M.I, kurse në mbrëmjen e datës 30.07.2019, e kishte kontaktuar V.... në për mjet telefonit dhe nga ai kishte kërkuar që të takohen për të udhëtuar në Shqipëri, duke potencuar se i njëjti nuk ka pasur njohuri se më kënd kishte qëndruar deri në atë kohë e pandehura V..... I pandehuri ka theksuar se me të pandehurën V.K ishin takuar në Prishtinë tek një pompë e derivateve, duke potencuar veturën e të dëmtuarit e kishte vozitur gjatë gjithë kohës V... dhe nuk ka pasur njohuri se vetura ka qenë e M.I dhe gjatë bisedës që kanë pasur me V....në lidhje me veturën e njëjta kishte potencuar se ishte e një shoqes së saj dhe e kishte marrë në huazim.

Më tutje i pandehuri në mbrojtjen e tij ka shtuar faktin se arsyeja e shkuarjes në Shqipëri ishte se i njëjti ishte shtetasi Shqipërisë dhe me kërkesën e V.... kishin dashur të shkonin në një festival veror në qytetin e Sarandës dhe V.... për disa ditë. Po ashtu ka potencuar se pasi që ishin në lidhje dashurie qëllimi i tij kishte qenë të fejohej me V....

### **Provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësor**

Pasi që të akuzuarit nuk kanë pranuar fajësinë sipas pretendimeve të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitën e këtij aktgjykimi.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor;
- përmes leximit të raportit të oficerit 2019-CF-1340 i datës 31.07.2019
- Raporti i policit hetues u datës 10.09.2019,

- Libreza e veturës me nr.MK 0929758, me dokumentacion tjetër për veturë.
- Raporti me hyrje-daljet kufitare e datës 31.07.2019, si dhe të datave 01.09.20110.09.2019,
- Fotografitë e bëra gjatë bisedave në viber në mes të pandehurës V.K dhe të dëmtuarit M.I,
- Video inçizimet kufitare,
- përmes dëgjimit të dëshmitarit- të dëmtuarit M.I
- si dhe fotodokumentacionit që gjendet në shkresat e lëndës.

### **Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht Gjykata vlerëson si të vërtetuar dhe të pakontestueshme në aspektin objektiv përkatësisht faktet si në vijim:

- e akuzuara V.K me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete e kanos të dëmtuarin M.I përmes aplikacionit Viber se do ti zbulojë diç në lidhje me të, duke tentuar ta detyroj të dëmtuarin të kryej veprim në dëm të pasurisë së tij në shumë prej 16.000 € / gjashtëmbëdhjetë/, si dhe:

Fillimisht para se të i vlerësojmë dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale është e nevojshme që të qartësohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme faktet në vijim:

- Mesazhet e shkruara në **viber**, drejtuar të dëmtuarit M.I

- Nga dëshmia e te dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit është vërtetuar se me të pandehurin kishte gene ne lidhje në kohëzgjatje prej 14 muajve, me të cilën kishte pasur raporte të mira, edhe pse nuk është takuar shpesh me të ata kanë komunikuar ne rrjetin Viber dhe jo në Whatsap, duke shtuar se e njëjta cdo muaj i ka ndërruar numrat e telefonit, gjatë muajit korrik që janë takuar pra me datë 30.07.2019, e pandehura ka pasur numrin që e ka deklaruar në Prokurori, ku me këtë datë janë takuar ne Fshatin Bibaj tek “Bibi” rreth orës 18:00-19:00, dhe së bashku me të dhe me makinën e tij Mercedes GLE 250, janë nisur për Prizren që të kalojnë

një natë atje, pastaj në Gjakovë dhe të kthehen për Ferizaj, mirëpo rrugës e akuzuara i kishte propozuar të njëjtit që të kthehen në qytetin e Ferizajit, përkatësisht në hotelin ..... ku edhe kishin mbërritur rreth orës 19:30. Gjatë qëndrimit aty kanë porositur ushqim dhe pije alkoolike, e akuzuara ka insistuar që i njëjti të bëjë tush dhe kur ka dalur nga tushi ia ka dhënë një gotë verë të kuqe që ta pijë “....”, duke ia bërë gëzuar, në fillim ka kundërshtuar pirjen e saj mirëpo pastaj e ka pirë dhe pas 2-3 minuta i njëjti më nuk ka ditur asgjë, vetëm kur është zgjuar në ora 5:30 në mëngjes dhe ka parë që e kishte zënë gjumi. Pasi është zgjuar ka parë dritën e banjës ndezur e ka thirrur të akuzuarën, mirëpo e ka parë që nuk ishte aty, është ngritur nga shtrati dhe e ka kërkuar në banjë dhe në garazhdë ku ka vërejtur se i mungon çelsi i veturës gjithashtu edhe vetura, paratë e gatshme që kishte me vete. Ndërsa në makinë i kishte, portofolin, 7-8 kartela të bankës, pasaportën e orës, pasaportën e tij, dokumentet personale, dokumentet e veturës, gjëra personale, telefona e kontrata të firmës e shumë gjëra të tjera të firmës dhe personale. Dhe pas gjithë kësaj ka thirrur në recepsion i ka pyetur se a ka dalur dikush me veturën e tij, ku i janë përgjigjur se rreth orës 23:00-23:30 ka dalur vetura e tij nga hoteli.

I njëjti shton se atë natë ka pirë vetëm nje shishe e gjysmë verë e cila ka qenë pak dhe nuk ka mundur që të dehet me të, sepse deri në dy litra verë nuk i ka ndodhur që të dehet, e duke konsideruar se e njëjta e akuzuara kishte hedhur diçka që kishte ndikuar që i njëjti te futet në gjumë të thellë.

Gjithashtu ka shtuar se pas ndodhisë në hotelin ....., me të akuzuarën ka komunikuar rreth orës 08:30-09:00 të mëngjesit ku e njëjta i ka treguar se gjendet në Shqipëri me veturën e tij dhe në këmbim të veturës i ka kërkuar 16.000 euro, duke i thënë mos ta lajmëroj policinë se “do ta nxi jetën”, i njëjti iu ka përgjigjur që të i’a sjellë vetëm dokumentet e veturën ndërsa sa i përket veturës i kishte kërkuar nga e njëjta që veturën ta mbante edhe t’ia ia kthente dokumentacionin. Gjithashtu i dëmtuari në theksimet e tij ka theksuar faktin, në komunikimin në për mjet telefonit V....e kishte shantazhuar se të njëjtin se ( **kam me ta lajmëruar bashkëshorten dhe kam me ja dergu videot siq janë edhe mesazhet e shkruara** ) duke shtuar se qëllimi i saj ka qen me kërkua para prej meje.

I dëmtuari ne deklaratimet e tij kishte theksuar se të akuzuarën V.... e kishte kontaktuar në telefon pasi që të njëjtën edhe më parë e kishte ndihmuar financiarisht deri ne shumën mbi 100/ njëqind mi euro/.



I dëmtuari ka shtuar edhe faktin se të akuzuarës V... ia kishte dhënë autorizimin të vozis veturën e tij vetëm në prezencën e tij dhe asnjëherë nuk ia ka dhënë që të vozitë e vetme, dhe jo vetëm këtë veturë por asnjë veturë tjetër dhe natën kritike e njëjta nuk i ka kërkuar leje dhe as nuk e ka ditur se ku ka shkuar me veturën e tij, por informatën se ku gjendet vetura e tij e ka marr nga shefja e Interpolit në Tiranë e cila i ka treguar se ku gjendet vetura e tij.

I njëjti më tutje ka deklaruar se pasi që ka lajmëruar në polici se i kanë vjedhur veturën, e ka thirrë në telefon babai i të pandehurit të dytë për t'ia dorëzuar atë, të cilën nuk ka dashur ta marr por prap janë marrë vesh që të takohen në një zyre të tij në Durrës e ta merr veturën, ku me datë 06.09.2019, kishte shkuar ortaku i tij dhe e ka marr, ndërsa vet ai si pronar i saj e ka marr veturën me datë 09.09.2019 dhe atë 38 ditë pas natës kritike.

“Gjithashtu i dëmtuari ka deklaruar se të akuzuarin e dyte S.L nuk e kishte njohur më parë por dhe nuk ishte takuar me të njëjtin të njëjtin nuk kishte asnjëherë, por pas këtij rasti ishte njoftuar se ka qene i i njohur me V... gjithashtu e ka shtu edhe faktin se e kishte marrë një telefonatë nga Shqipëria duke i thënë me fjalët ose “ose sjelli leket ne Shqipëri se përndryshe do ta djegim makinën”. Mirëpo në theksimet e tij i njëjti nuk kishte pasur njohuri se kush ka qene personi i cili e kishte telefonuar.

Më tutje dëshmitari - dëmtuarit ka theksuar se qëllimi i të akuzuarës sipas tij kishte qenë marrja e shumës së parave prej 16.000/gjashtëmbëdhjetë mijë euro/ gjithashtu se kërcënimi që iu ka bërë të njëjtit ishte përfitimi i parave në shumën e lartcekur, e njëjta e kishte kërcënuar se nëse nuk ia ofron këtë shumë të parave do ta lajmëronte ose do ta njoftonte bashkëshorten e të dëmtuarit M...se do t'i dërgonte t të gjitha videot dhe mesazhet bashkëshortes së tij, gjithashtu shton se V... ka tentuar të bisedoj më të edhe pas këtij rasti dhe atë 2-3 herë mirëpo i njëjti nuk ka pranuar duke i thënë se nuk kemi më se çfarë të bisedojmë, dhe herën e fundit kur kishte komunikuar me të e njëjta iu kishte drejtuar me fjalët se “qeta që ma ke bërë do ta nxijë jetën”,

I dëmtuari deklaron se i njëjti nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-jurdike.

Gjykata në këtë rast me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit M.I ku duke pasur parasysh rrethanat të njëjtën e bëjnë të vështirë dhe komplekse në vlerësimin e saj, megjithatë dëshmia e tij është e saktë dhe objektive për më tepër tërësisht të besueshme, e po ashtu në harmoni të plotë edhe me provat materiale, sidomos me mesazhet e dërguara në Viber nga e akuzuara e parë, ku përshkruhen se si e njëjta ka kërkuar nga i

dëmtuari një shumë të të hollave se përndryshe do të zbulojë diçka në lidhje me të, e po ashtu edhe me fotografitë e vendit të ngjarjes.

Prokurori i Shtetit Albana Porduzi, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe elaborimit të saj ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtores dhe të u shqiptoj dënim sipas ligjit, pasi që gjatë këtij shqyrtimit përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer vepra penale ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës, e cila është vërtetuar edhe nga dëshmia e të dëmtuarit M.I, i cili në shqyrtim gjyqësor është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit, ku qëllimi i të akuzuarve nuk ishte shëtitja me veturë po përvetësimi i pasurisë së huaj të luajtshme me qëllim që vetes të i sjellin dobi të kundërligjshme pasurore, ndërsa nga deklarata e të dëmtuarit dhe mesazheve të nxjerrura nga viberi vërtetohet se e akuzuara V.Kkishte shantazhuar të njëjtin. Andaj ka kërkuar nga Gjykata, që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

**Mbrojtësja me autorizim i te pandehurës V.K, Av.D.H** në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe elaborimit të saj në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se duke marrë parasysh provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, deklaratës së të dëmtuarit si dhe mbrojtjen e të pandehurës V.K, nuk është arritur të provohet së e njëjta ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, pasi që në veprimet e saj nuk manifestohen elementet e këtyre veprave penale. Duke shtuar se sa i përket veprës penale nga dispozitivi i parë aktakuzës vjedhje e rëndë në bashkëkryerje, e mbrojtura e saj është akuzuar në kundërshtime me ligjin pasi që në veprimet e saj nuk manifestohen elementet e kësaj vepre por të veprës penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme nga neni 319 par.1 të KPRK-së, duke e cituar dispozitën në fjalë, si dhe duke vazhduar se në rastin konkret i dëmtuari është njoftuar nga e pandehura se gjendet jashtë vendit dhe e ka veturën e tij, dhe sipas kësaj nuk përmbushen elementet e përvetësimit të veturës, sepse e njëjta nuk është shitur nuk është humbur por vetëm është përvetësuar përkohësisht dhe më vonë është kthyer tek pronari. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 319 të KPRK-së thuhet se procedura penale për veprën nga par.1 i këtij neni, fillohet në bazë të propozimit të të dëmtuarit, mirëpo vetura të njëjtit i është kthyer, dhe nuk ka bazë për inicim të kësaj procedure. Kurse sa i përket veprës penale shantazhi, nuk ekziston asnjë provë me anë të së cilës vërtetohet se ato mesazhe në viber i ka dërguar e mbrojtura e tij sepse nuk është cekur

nga cili numër i ka pranuar i dëmtuari ato mesazhe dhe nuk është vërtetuar se cilin numër të telefonit ka poseduar e pandehura në kohën e kryerjes së kësaj vepre penale, ku e pandehura me të dëmtuarin nuk kanë biseduar ne Viber por në Whats up.

I ka propozuar Gjykatës që të pandehurën V.K ta liroj nga aktakuza në mungesë të provave sepse nuk është vërtetuar se e njëjta ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Duke kërkuar nga gjykata se në rast se të njëjtën e gjen fajtor për veprën penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme nga neni 319 par.1 të KPRK-së, të i shqiptoj një dënim sa më të butë duke marrë parasysh moshën e saj në kohën e kryerjes së veprës penale si dhe sinqeritetin e saj në këtë shqyrtim gjyqësor.

Mbrojtësi me autorizim i te akuzuarit S.L, Av. A.H, ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, pas dëgjimit të dëmtuarit dhe provave të administruara nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale sipas pikës 1 të aktakuzës, si dhe pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar as gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e parë të aktakuzës, pasi që nga ky përshkrim nuk formësohen elementet e veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje dhe nuk është vërtetuar në asnjë rrethanë së i mbrojturi i tij ka kryer këtë vepër penale, kjo nga fakti se në asnjë rast nuk është përmendur marrëveshja paraprake në mes të mbrojturit të tij dhe të akuzuarës së parë, prandaj nuk mund bashkëveprojnë në bashkëkryerje nëse nuk kanë marrëveshje paraprake në mes tyre për kryerjen e veprës penale, dhe në rastin e tillë nuk kemi kontribut esencial në kryerjen e kësaj vepre sepse e pandehura e parë pasi që ka marrë veturën nga i dëmtuari është takuar me të pandehurin e dytë dhe janë larguar jashtë vendit-Shqipëri, ku i njëjti nuk ka qenë në dijeni se e kujt është vetura dhe udhëtimi me të dashurën e tij me veturën për të cilën ka menduar se është e saj nuk përbën vepër penale.

I njëjti me tutje shton se ne rastin konkret nga provat materiale nuk është vërtetuar se i pandehuri i dytë ka kryer këtë vepër penale si dhe nga vetë deklarata e të dëmtuarit e dhënë në shqyrtim asnjë herë nuk është përmendur ai dhe as që e din se ekziston një person me emrin e tillë, duke shtuar se nuk ka punë me këtë person, andaj sipas tij si ka mundur të vërtetohet kjo gjendje faktike ku i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka kërkuar dëmshpërblim sepse vetura i është kthyer, ka kërkuar nga gjykata që në rastin konkret të marrë aktgjykim lirues.

### **Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit**

Gjykata me një vëmendje të posaçme dhe kujdes të shtuar e ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarës V.K të dhënë shqyrtimin gjyqësor , mirëpo pretendimet e të akuzuarës, se nuk e ka kryer veprën penale, në tentativë shantazhi nga neni 329 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së,

### **Vlerësimi i tezës së mbrojtëses të të akuzuarës**

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit av. D.H , të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka pretenduar se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer asnjë veprë penale dhe ka kërkuar lirimin e saj nga të gjitha akuzat.

Fillimisht mbrojtësi i të akuzuarit ka potencuar faktet kontestuese se i akuzuara V... sa i përketë veprës penale shantazhi, Gjykata i vlerësoi si jo reale dhe jo të besueshëm, nga se një pretendim i tillë nuk mund të vërtetoi me asnjë provë bindëse dhe për me tepër ky pretendim është në kundërtënie të plotë me mesazhet e shkruara në viber drejtuar të dëmtuarit.

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarës V.K, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale në tentativë shantazhi nga neni 329 par.2 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e cila përcaktohet edhe nga përkrahimi ligjor i dispozitës është përcaktuar: *“kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo tjetrin, kanos personin tjetër se do të zblojë diç në lidhje me të ....”*, kurse edhe nga përkrahimi ligjor i dispozitës së nenit 28 të KPRK-së është përcaktuar: *“ Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprë penale ”*

### **Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës, gjykata duke i aplikuar dispozitatat e nenit 70, 71 dhe 72, bëri zbutjen e dënimit nga minimumi i paraparë ligjor nga një vitë burgim në gjashtë muaj burgim dhe me pëlqimin e të akuzuarës konform dispozitave të nenit 44 par. 1 të KPRK-së , i zëvendësoi me dënim me gjobë në shumë prej 1000/njëmijë euro/dhe gjeti si rrethana lehtësuese të cilat ishin të natyrës ekskluzivisht personale se i e akuzuara është i

padënuar deri tani me aktgjykim të formës së prerë për vepër tjetër penale dhe këtë e ndërlidhi me faktin se është e moshës relativisht e re, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti, po pati parasysh mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

Megjithatë, Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit është e bindur se me anë të këtyre dënimeve është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, dhe se me anë të këtyre dënimeve do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

**Sa i përket pjesës liruese për dispozitivin e parë** të aktgjykimit drejtim të akuzuarve V.K dhe S.L nuk manifestohen elementet qenësore të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ku elementet e saj përcaktohen edhe në përshkrimin ligjor të dispozitës 313 par.1 të KPRK-së, se “*Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë apo tjetrit*” e që në kuptim të par.2 dhe pikës 2.1 të nenit 315 “*pasuria apo shërbimi i vjedhur ka vlerë mbi prsëmijë (5.000) €*”, e cila përmbushë elementet thelbësore të vjedhjes së rëndë, mirëpo në rastin konkretë marrja e veturës palës së dëmtuar nuk kishte për qëllim përvetësimin e saj në mënyrë të kundërligjshëm për vete apo tjetrin, por përdorimin e saj për përmbushjen e elementeve të veprës penale shantazhi, e në rastin konkretë përvetësimin e shumës prej 16.000 €, duke përdorur si mjetë veturën e tij, ndërsa sa i përket kryerjes së kësaj vepre në bashkëkryerje, në kuptim të dispozitës së nenit 31 të KPRK-së, se “*Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke kontribuar në kryerjen e saj*”, në rastin konkretë nuk përmbushet elementi thelbësor i saj, i cili është kontributi esencial në kryerjen e kësaj vepre penale nuk janë përmbushur elementet e dashjes direkte dhe qëllimi i kryerjes së veprës penale dhe atë duke marrë parasysh kuptimin e kësaj dispozite dhe përshkrimin faktik se si ka ndodhur kjo vepër penale, andaj Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në lidhje me veprën penale në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Nga të akuzuarit, nuk vërtetohet se të njëjtit kanë marrë këtë veturë nga i dëmtuari më qëllim të përfitimit të dobisë pasurorë, duke e shitur apo përdorur për vete, por vetëm e kanë përdorur të njëjten për të realizuar elementet e veprës penale të përshkruar në pikën dy të aktakuzës.

### **Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të shtetit**

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare ka mbetur pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke propozuar që e akuzuarit të shpallen fajtor dhe të u shqiptohet dënim sipas ligjit, duke përshkruar provat materiale.

Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se të akuzuarit janë kryerës të kësaj veprë penale, por, shumica e pretendimeve të saj kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të bazuar mirë, pra nuk ka arritur të provojë se të pandehurit janë kryes të kësaj veprë penale, e sidomos për të akuzuarin S.... i cili kishte qen vetëm shoqërues i të dashurës së saj në veturën e të dëmtuarit.

Fokusi i fjalës përfundimtare mbështetet vetëm në (dëshminë e dëshmitarit-të dëmtuarit M.I) dhe provat material raporti i të hyrave dhe daljeve kufitare në kohën e kryerjes së veprës penale, të cilat do ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

së pari veprimin e të pandehurve përshkruan në mënyrë abstrakte dhe në vija tejet të përgjithësuara pa elaboruar hollësi dhe detaje, për më tepër e gjithë këtë veprim të tyre i përshkruan se e pandehura e parë “ *me datë 30-31.07.2019, ia merr pasurinë të dëmtuarit M.I me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë që deri sa ishte me të dëmtuarin në motelin e lartcekur, e shfrytëzon situatën kur ai ishte në gjumë dhe ia merr veturën e tipit Mercedes GLE, ngjyrë të bardhë, me targa ....., në vlerë prej 94.000 €, pasaportën, letërnjoftimin, disa kartela të bankës dhe 400 € para kesh dhe para të Maqedonisë në konvertim në 100 €, pasaportën e orës*”, si dhe këtë vepër e ka kryer në bashkëkryerje me të pandehurin e dytë, duke theksuar se të njëjtit janë marrë vesh që të takohen dhe të nisen për në Shqipëri ku i njëjti thelbësisht kontribuon në kryerjen e kësaj veprë penale duke e kaluar veturën jashtë kufirit për në Shqipëri.

Më tutje Prokurorja i Shtetit vazhdon me paraqitjen e fjalës përfundimtare se “*...se qëllimi i të pandehurve nuk ishte shëtitja por përvetësimi i pasurisë së huaj të luajtshme me qëllim që vetes të i sjellin përfitim pasuror vërtetohet edhe nga vet deklarami i të pandehurit të dytë Salvador Luka, i cili ka deklaruar se ka shkuar të takohet me të pandehurën e parë dhe ka lënë veturën e tij në pomp të derivateve dhe me veturën e të dëmtuarit janë nisur për në Shqipëri, një gjë vërtetohet edhe nga prova materiale-raporti i hyrjeve dhe dalje kufitare...*”, mirëpo për gjykatën një gjë e tillë nuk ishte kontestuese sepse e pandehura e ka pranuar se i ka marrë veturën nga i dëmtuarit dhe e kishte lënë ne Hotelin..... gjë që është vërtetuar edhe nga fototot e hyrjeve dhe daljeve në kufirin Kosovë – Shqipëri dhe së bashku me të dashurin e saj- të

pandehurin e dytë kanë shkuar për Shqipëri, por e njëjta e mohon faktin e vjedhjes së kësaj veture, ku qëllimi i saj ishte vetëm për një shëtitje, me që u vërtetua e fakti nga vet dëshmitari – i dëmtuari se e akuzuara nuk ishte ndaluar asnjëherë nga i dëmtuari që të vozis veturën e tij duke i thënë “ *cfarëdo që është e imja është edhe e jotja*”. *Epo ashtu nuk është vërtetuar me asnjë provë se i akuzuari S.... ka pas ndonjë marrëveshje paraprake me të akuzuarën V.K për kryerjen j veprës penale, vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, siq pretendon prokuroria e shtetit.*

Nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarve, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

### **Kërkesa pasurore – juridike dhe shpenzimet procedurale**

Në kuptim të nenit 461 par. 1 të KPP-së, i dëmtuari M.I nuk ka parashtruar kërkesës pasurore – juridike.

Vendimi mbi shpenzimet paushallit gjyqësor është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

**P.nr.1013/19 e datës 06.11.2019 .**

**Zyrtare ligjore,**

**Lavdije Brahimi-Aliu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**

**Hakile Ilazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.